

VENDIM
Nr.426, datë 22.4.2009

**PËR SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË
DËRGUAR ME MISIONE USHTARAKE JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 6 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me INSIG, sh.a., të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që janë me mision ushtarak jashtë vendit, me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2009, miratuar për këtë ministri.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe INSIG, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha